



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0019837-1/24 dt. 28.03.2024

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja e 27

Koha: 28.03.2024 ora 10:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Shkurta Shosholli Musa, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani, Muhamed Hoti dhe Xhyljeta Imeri

Drejtorët e Drejtorive

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e njëzeteshtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa, me rendin e ditë të paraparë me thirrje.

Në vazhdim Kryesuesja u tha anëtarëve të KPF-së se para vetës keni Draft-Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2019 Për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, e cila propozohet të hyjë në rend dite.

Kryesuesja hapi diskutimin për rendin e ditës.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja vuri në votim propozimin që pikë e 3-të e rendit të ditës të jetë Draft-Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2019 Për taksa, tarifa dhe gjoba komunale.

Komiteti për Politikë dhe Financa unanimitisht miratoi propozimin që pikë e 3-të e rendit të ditës të jetë Draft-Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2019 Për taksa, tarifa dhe gjoba komunale.

Në vazhdim Kryesuesja vuri në votim këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

2. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Mitrovicës
3. Draft-Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2019 Për taksa, tarifa dhe gjoha komunale

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hapë diskutimin lidhur me Kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Mitrovicës, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtoreshës së DBF-së znj. Igballe Islami.

Pas arsyetimit të pikës nga Drejtoresha e DBF-së znj. Igballe Islami, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Fadil Veseli: Sa i përket investimeve kapitale kërkoj nga drejtoria përkatëse të jenë më të kujdesshëm te rrugët, të jenë më të rreptë edhe me pronarët e pronave kur bëhet fjalë për hapjen e rrugëve. Te varrezat e fshatit Broboniq ujërat e zeza kanë dalë në rrugë, kundërmon era, sa më shpejtë të gjendet një zgjedhje.

Igballe Islami: Në seancën e Kuvendit do t'ua sjellë shtojcën ku Komunës së Mitrovicës do t'i barten në investimet kapitale 767.000 € në mënyrë automatike nga divizioni i buxhetit, këtu do të barten disa mjete që kanë mbetur pa u shpenzuar në disa projekte që Komuna e Mitrovicës nuk ka arritur me marrë leje prej ASHI-së. Krejt çka na është konfirmuar nga Departamenti i buxhetit është thënë se ju duhet vetëm ti ridestinoni përmes transfereve në asamblëtë e juaja komunale, menjëherë në seancën e prillit planifikojmë që mjetet ku e shohim se nuk ka mundësi të shpenzimit t'i transferojmë.

Hysen Muzliukaj: Me sa e kuptova do të ketë transfer të mjeteve në një seancë të Kuvendit, a i bie se do të vie drejt në KK pa kaluar në KPF apo do të ketë edhe një mbledhje të KPF-së, nëse do të shqyrtohet në KPF i bie se do të mbahen dy seanca të Kuvendit. Ndërsa sa i përket transferit ju e keni dituar në muajin tetor se do të ketë transfer, ka qenë temë e diskutimit prej kur ka filluar puna e tatimit në pronë, po ashtu ka qenë temë e diskutimit që bartja e të hyrave mos me ndodhë vit për vit, por me ndejtë tri vite dhe në vitin e katërt me i shfrytëzuar. Ndërsa sa i përket bartjes së mjeteve në projekt të caktuar kjo ka ndodhur për shkak se këto projekte me siguri kanë qenë të planifikuara vitin e kaluar ose pse nuk ka filluar ende projekti, kjo lidhet me mos punën e juaj, për arsye se kur bëhet një projekt duhet të fillojnë disa procedura, të paktën të kemi një kontratë kornizë, për shkak se nuk kanë filluar procedurat ministria i bartë mjetet në ato projekte. Unë dyshoj se Ministria ka me lejuar këtë transfer.

Igballe Islami: Ne si komunë jemi njoftuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës në një takim në muajin shkurt dhe na është thënë se jemi duke tentuar me i bartë të hyrat në mënyrë automatike, këto të hyra do të barten në projektet e planifikuara në vitin 2023 dhe ne si komunë nuk fillojmë me procedurat pa e marrë konfirmimin e ligjshmërisë. Sa i përket pikës për transfer të mjeteve do të respektohen të gjitha procedurat, së pari do të shqyrtohet në KPF, pastaj përmes tij në Kuvend, nëse merret vendimi do të shkoj për konfirmim të ligjshmërisë në MAPL dhe në departamentin e buxhetit.

Erseka Barani: Në mbledhjen e fundit të Kuvendit kam bërë një propozim për një kategori të ndjeshme që ka qenë me i nda një pjesë të subvencioneve për gratë viktime të dhunës në

familje, mirëpo prej 180.000 € që janë planifikuar nuk po e shoh se është ndarë të paktën asnjë shumë minimale, qëllimi i propozimit muajin e kaluar ka qenë që të planifikohen me bartje të të hyrave, nuk është numër i madh i atyre viktimave, objekti për strehimin e tyre ende nuk ka përfunduar, gjendja e objektit ku janë nuk është e mirë, a është diskutuar me drejtoreshën e Qendrës “Raba Voca” sa është numri i viktimave të dhunës në familje që janë strehuar momentalisht aty, dhe se pagesa e qirasë në atë objekt është shumë e nevojshme.

Drita Ibrahim: Sa i përket subvencionit të Strehimores “Raba Voca” ne kemi iniciuar të gjitha procedurat për një bashkëpunim ndërkomunal Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri, dy komunat tjera nuk kanë shprehë gatishmëri për ta nënshkruar marrëveshjen, nuk kemi hasur në mirëkuptim. Ne si drejtori i kemi ndihmuar këto gra në të gjitha mënyrat, Strehimorja po ndërtohet, vetëm pagesa e qirasë ka mbetur pezull, ne si drejtori nuk kemi mundësi t’i subvencionojmë të gjitha ato gra me mjete financiare, ne do të provojmë t’i punësojmë në sektorin privat.

Hysen Muzliukaj: Pse nuk është nënshkruar marrëveshja nga dy komunat tjera, a kanë dhënë ndonjë arsytim?

Drita Ibrahim: Na është thënë se nuk ka bazë ligjore.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Mitrovicës.

Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Mitrovicës u miratua unanimitisht (9-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe e njëjta i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Draft-Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2019 Për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtoreshës së DBF-së znj. Igballe Islami.

Pas arsytimit të pikës nga Drejtoresha e DBF-së znj. Igballe Islami, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Xhyljeta Imeri: Edhe herën e kaluar kur ka qenë në rendi dite kjo pikë kam kërkuar që për shkak se kemi të bëjmë me taksa, tarifa dhe gjoba komunale për mbledhjen e Kuvendit ta kemi edhe Rregulloren Nr. 02/2019 në mënyrë që të dimë se çka po ndryshohet.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Draft-Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2019 Për taksa, tarifa dhe gjoba komunale.

Draft-Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2019 Për taksa, tarifa dhe gjoba komunale u miratua unanimitisht (9-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe e njëjta i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 10:50 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Merita PRETENI

Kryesuesja e Kuvendit


Vesa BROJA

